



Nr: 13/2023
Nr. Protokolli: 20/2023
Date: 10.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës: 06.03.2023 të parashtruar nga OE; **QAPA SH.P.K. Magjistratja Prishtine-Ferizaj km5, 10000, Prishtina Xk** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Vlersimi rapid i shkollave - faza e parë**, me Nr. të Prokurimi **624-22-13949-2-2-1 & 624-022-134-221** nxjerr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Pjesërisht** kërkesas për ri-shqyrtim të datës 06.03.2023, e parashtruar nga OE; **QAPA SH.P.K. Magjistratja Prishtine-Ferizaj km5, 10000, Prishtina Xk** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:
Vlersimi rapid i shkollave - faza e parë, me Nr. të Prokurimi **624-22-13949-2-2-1 & 624-022-134-221**, Kunder Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – të datës 01.03.2023 të publikuar në platformen elektronike.
- Anulohet njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 01.03.2023 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Pretendimi 1 - Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Konsorciumi i rekomanduar per kontrate nga KK Suhareke nuk i ploteson kriteret teknike dhe profesionale sipas dosjes se tenderit.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 1 – Sa i perket ketij pretendimi, komisioni i vlerësimit i ka vlerësuar te gjitha ofertat e OE, dhe gjate ketij vleresimi OE fitues i ka palotesuar te gjitha kriteret qe parashihen ne FDT.

Pretendimi 2 - Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Shkelja ne kete pike eshte bere ngaqe asnje nga anetaret e konsorciumit ne veprimtarite e tyre te regjistruar ne ARBK, nuk kane lemi te arsimit, kjo nenkupton qeketo dy kompani nuk e plotesojne pershtatshmerine profesionale te kerkuar sipas dosjes se tenderit

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 2 – Sa i perket ketij pretendimi, Autoriteti kontraktues (siç e keni cekur edhe ju në pretendimin ankimor) bazuar në paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-ës “do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. AK ne FDT nuk ka kërkuar veprimtari perkatese, Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë si në vijim: “*Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit*” ndërsa dëshmia sa i përketë kërkesës së lartë përmendur ka qenë e përcaktuar si në vijim: *Dëshmia1- Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje)*. Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar dëshmi mbi regjistrimin në ARBK me të cilën dëshmon se ushtrimi i veprimtarisë së tij mirret me Hulumtim të tregut dhe matje te opinionit Publik gjë qe nuk bie ndesh me fushë veprimin e aktivitetet te prokurimit në fjalë.

Gjithashtu komisioni i vlersimit pas vleresimit te ofertave, dhe duke e pase parasysh ruajtjen e parase publike si parim bazë i LPP-se, ka propozuar për Kontratë Operatorin Ekonomik i cili ka ofertuar me çmim me te lire, dhe ka rekomanduar ZPP-ne qe te shpall fitues kete OE.

Pretendimi 3 - Shkelja e dyte e pretenduar ka te beje me kontratat e realizuara.

Sipas kriterit kontrata te ngjajshme te realizuara, nga ky koncorsium I shpallur fitues jane dorezuar dy kontrata te cilat edhe pse jane sherbime, nuk kane te bejne me fushen e arsimit, pasi qe jane sherbime te trajnimit per fermere, dhe Sherbime inspektuese perverifikim- anketimin e pronave te paluajtshme te tatimit ne prone dhe kryerja e sherbimeve per inkasim dhe mbledhja e detyrueshme e obligimeve te tatimit ne prone.

Gjithashtu ekzistojne raporte te ndryshme por mungojne raporte per perfundim te kenaqshem te sherbimeve ose referencat.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 3 – Pretendimi me Nr 3 është i bazuar.

Pretendimi 4 - Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;

LIGJI Nr. 04/L-042, Neni 69 pikes 4.1

Lidhur me kriterin per kerkesen e listes se eksperteve te arsimit, nga operatoret ne fjalejane dorezuar konkretisht 4 eksperte te arsimit, ku kualifikimet e tyre shkollore dhe profesionale nuk perputhen me kerkesen.

Deshmia 1: Korab Krasniqi- posedon kualifikim shkollor – Master I shkencave te inxhinierise mekanike, I cili nuk mund te cilesoshet ekspert I arsimit pasiqe nuk ka thirrje profesionale ne fushen edukativo arsimore- Shkenca Sociale, dhe e gjithe pervoja e tij perkon ne Inxhinieri

Deshmia 2: Shqipe Xhemajlaj- posedon vetem nje certifikate per : Vleresimin e performances se shkolles, ndersa kualifikim shkollor posedon Diplome dhe Master te fushes se Ekonomise, njekohesisht eshte e licensuar si auditore ne Komunen e Drenasit kudhe aktualisht eshte ne maredhenie te punes ne komunen e Drenasit.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 4 – Gjithashtu pretendimit nr 4. Autoriteti Kontraktues e vlerëson si të qëndrueshem dhe të bazuar.

Këshilla Juridike: Kunder këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shefi Zyres së Prokurimit
Fatos Kushi

